

Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë

Novi Sad, Serbi

20 mars 2010

Grupi punues: Mandati i KOMRA-së (REKOM)

Propozimet, opinionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve:

KOMRA nuk duhet të merret me pasojat

Mua, duhet ta pranoj, ky varianti i parë, do të thotë vetëm provat, posaçërisht nëse mendohet se vetëm kohëzgjatja e KOMRA-së do të jetë i kufizuar në kohë, (...) e bënë më të pranueshëm (...) nëse shkohet në mënyrë të themeltë në provat, pa marrë parasysh se a do të jetë nga 1 janari i vitit 1918 ose nga 1 maji i vitit 1945, ose nga Jajce e vitit 1943, është e domosdoshme që të përfshihen tmerrësisht në thellësi dhe nivelin e interpretimit. Nuk jam i sigurt që, posaçërisht duke marrë parasysh kohën e shkurtër, do të jetë i mundshëm që të realizohet (...), pajtueshmëria lidhur me këtë interpretim. (Tihomir Ponoš, Novi list, Hrvatska, Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mekanizmat e këtyre luftërave kanë filluar në vitet e '80-ta.

Duhet të shqyrtohen vitet e '80-ta, sepse ato janë vitet kur kanë nisur mekanizmat e kësaj lufte. Do të thotë, nuk është 1918, ose 1945 (...) gjithsesi 1987 e shoh si të qenësishme, por ndoshta edhe më herët, dhe kjo nuk është relevante vetëm për Kroacinë, por për të gjithë territorin e ish RSFJ-së. (Nela Pamuković, Centar za žene žrtve rata Rosa, Hrvatska, Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Kompetenca kohore e KOMRA duhet të jetë nga shpallja e RFPJ.

(...) është mendimi im, kur kemi të bëjmë me çështjen e kompetencës kohore (...) pas 20 nëntorit 1943 kur është shpallur, këtu shkruan Republika Demokratike e Jugosllavisë, gjegjësisht 29 nëntori i 1945, kur është shpallur RFPJ. (Slavko Kecman, Udruga za mir Bilje, Hrvatska, Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mandati i KOMRA-së duhet të jetë që nga Lufta e dytë botërore

Propozimi im është që Mandati i KOMRA-së duhet të mbulojë periudhën nga Lufta e dytë botërore. Përse e them këtë – duke pasur parasysh Rezolutën e Bashkimit Evropian e cila ka të bëjë me dënimin e krimeve nga periudha komuniste. (Ruzhdi Jashari, shoqata e veteranëve dhe invalidëve ushtarak të luftës, Shtime, Kosovë. Forumi i gjashtë

regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qëllimi i KOMRA nuk është vërtetimi i fakteve historike, por vërtetimi i fakteve të cilat kanë të bëjnë në krimet e luftës

(...) a është objektiv, qëllimi i KOMRA për vërtetimin e fakteve historike ose objektiv për vërtetimin e fakteve të cilat kanë të bëjnë me krimet e luftës? Unë e kam kuptuar – këtë të dytën. Sipas meje, KOMRA nuk ka ambicie që të merret me faktet historike, kjo i përket një shkence pak më të lartë, historianëve dhe profesioneve tjera, por ky komision do të kishte një qëllim që para se gjithash të merrej me vërtetimin e fakteve të cilat janë prej një interesi për krimet e luftës. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të vërtetojë faktet nga viti 1991 deri në vitin 2001

(...) Pjesa hyrëse, pa asnjë problem, mund t'i sqarojë të gjitha, të ofrojë se çfarë ka ngjarë para vitit 1991, por është shumë vështirë të paramendohet që një komision të vërtetojë faktet lidhur me atë se çfarë ka ngjarë në Plenumin e Brioneve, për atë, për demonstratat e studentëve shqiptarë të vitit 1981, për Maspok - un e vitit 1971, kjo është një punë mjaft, mjaft e madhe. Mendoj që praktikisht do të pamundësonin komisionin që të kryejë punën e vet, nëse do i jepnin mandatin për vërtetimin e fakteve lidhur me ato (...) un, bile, besoj që se duhet të vërtetohen faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda e të drejtave të njeriut që na viti 1991 e deri në vitin 2001. (Dragan Popović, Inicijativa mladih za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Është me rëndësi të vërtetohen faktet. Do duhej të vërtetoheshin që nga vitet '80-ta

Mendoj që është shumë me rëndësi që eksitojnë shkaktarët, të vërtetohen shkaktarët për shkak të asaj që të mos përsëriten gabimet. Tani, cila periudhë është kjo? Unë mendoj se këto solucione janë të shtruara tepër gjerësisht. Sipas meje, ndoshta, eventualisht, komisioni i ekspertëve do të mund të merrej me këto çështje, dhe ndoshta ai mund të ofrojë ndonjë propozim. Sipas meje ato do të ishin vitet e '80- ta. (Sonja Radošević, gazetarë e pavarur, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk duhet të hulumtojë të kaluarën e largët.

(...) Duke marrë parasysh se keni konstatuar që duhet të shkohet edhe më tutje në të kaluarën, mos ndoshta me këtë ekziston frika se KOMRA do të vihet në një situatë që mos të jetë në gjendje të përgjigjet në të gjitha kërkesat, që (...) para tij shtrohet një detyrë tepër e rëndë, dhe detyrë mjaft voluminoze, dhe se ndoshta, në fund të fundit, vet

obligimi i KOMRA-së të zbërthehet dhe të rrënohet mu për atë se do të jetë një aparat shumë më i madh i njerëzve, një mënyrë që të kryejë të gjitha ato, t'i vërtetojë. (Zvonko Ninkov, Linet, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Të shkohet lartë në të kaluarën paraqet një labirint ku nuk mund të gjendeshim, dhe as të gjejmë edhe vetveten. Nga ajo periudhë nevojiten dëshmitarët. Neve na duhet diçka konkrete. Dhe diçka të tillë nuk ka. (Narcis Mišanović, Boračka organizacija, Sarajevo, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk duhet të merret me kontekstin, sepse ai nuk mund të hulumtohet mjaft mirë, por nuk mund të arrihet një marrëveshje për vitin nga i cili duhet të fillonin hulumtimet.

Nëse thoni kontekst, dhe filloni nga konteksti, kjo nënkupton se keni gjykuar. Çfarë është konkludimi nëse keni filluar me gjykimin? Kur do t'ju besoj nëse keni gjykuar për diçka që as që dimë, dhe as që jemi profesionist të mjaftueshëm, dhe as që ka dëshmitarë lidhur me atë. Nuk mund të merremi vesh se nga kur do të fillojmë. Siç thoni a dëshirojmë nga Beteja e Kosovës ose nga viti 1943? Përse nga viti 1943, dhe jo nga viti 1941? Përse nga viti 1918, e jo nga një vit tjetër? (Mijoljub Vitorović, Specijalno tužilaštvo za ratne zločine, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Shkaqet duhet hulumtuar që nga viti 1987

(...) Unë propozoj që të verifikohen të gjitha gjërat që nga viti 1987. Atëherë bëheshin përgatitjet deri në vitin 1991, dhe atëherë u krijuan kushtet që të krste pushka e parë që të fillonte lufta. (Ekrem Hadžić, Udruženje za zaštitu prava proteranih i raseljenih iz Opštine Priboj, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Në territorin e ish Jugosllavisë nuk ekziston pajtueshmëri as për faktet elementare, për këtë shkak së pari duhet të arrihet një koncenzus lidhur me atë se çfarë ka ndodhur

(...) Probleme me këtë dilemë, se ato vërtetohen shkaktarët apo faktet, është ajo se tek ne nuk ekziston as pajtueshmëri lidhur me faktet elementare. Te ne ekziston gjendja e kundërshtimit në vendet e ish Jugosllavisë ku mohohet numri i viktimave, mohohen viktimat si të tilla, mohohen krimet si të tilla. Prandaj, ne duhet së pari të arrijmë një koncenzus lidhur me atë se çfarë ka ndodhur. (Marijana Toma, Impunity Èatch, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Ekzistojnë krime të shumta për të cilat, pothuaj se nuk dihet asgjë. KOMRA duhet të merret me faktet. Ai nuk ka kapacitete që të merret me çështje tjera.

(...) Mendoj që për neve faktet janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe ne nuk kemi kapacitete për diçka më shumë, dhe do të dëshiroja që dikush të më prezantojë argumentet se ne i kemi. Kemi aq shumë krime të hatashme për të cilat ne asgjë nuk dimë. (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

(...) Supozojmë, se vërtetë do vije ajo situatë kur shtetet do të marrin, pranojnë këtë iniciativë tonën, dhe tani bëhet çështje themelore, se a janë faktet dhe pasojat e luftës. A mund të paramendoni ju se ato shtete do të pajtoheshin lidhur me shkaqet e luftës? Unë nuk mund ta paramendoj fare (...) këto pushtete sot, nuk janë pushtete demokratike, ku çdo pushtet do të merr përsipër përgjegjësinë për të bëmat e pushtetit të mëparshëm. Ato janë pushtete transitore. Nëse ne i përfitojmë për faktet, unë mendoj se ajo, realisht, do të ishte një fitore, asnjëherë në këto territore nuk kishte fakte, kurrë. Në vitin 1991 në kokat e njerëzve gjithmonë ishin interpretimet nga viti 1941. (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

A i duhet KOMRA-së që përshkrimi i kontekstit të konflikteve nga aktgjykimi i Tribunalit të Hagës të merret si burim?

Te ne, mund të dëgjojmë edhe mendime kurrë thonë, jo, ne nuk pranojmë atë çka vërteton Tribunali i Hagës. Por kjo është në nivelin politik, ndërsa në nivelin shtetëror a është e mundur që ndonjë shtet të pohojë se ne nuk e pranojmë? Çfarë ndodhë me narrativet e kontekstit nga të cilat fillojnë të gjitha aktgjykimet, arsyetimet? A pranohet kjo në mënyrë automatike, hyrjet në burime të cilat do të shfrytëzohen nga komisioni mu për qëllim të përshkrimit të kontekstit nga ana e vet? (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mund të ofrohen interpretime të ndryshme të kontekstit nga interpretimi i aktgjykimeve të Hagës

Ato që gjenden në aktgjykimet e Hagës për hulumtimet në të ardhmen, interpretimet e ardhshme, historianët e ardhshëm, realisht, nuk do të thotë shumë. Ata mund të thirren në ato, por nuk janë të obligueshëm, por as që t'i pranojnë ato, nuk janë të detyrueshëm, mund të ofrojnë të reja, interpretime të tjera. (Tihomir Ponoš, Novi list, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Shkaqet duhet hulumtuar që nga viti 1981

Gjendja e rëndë në Kosovë ka filluar shumë më herët nga viti '98,99, por unë do filloja me vitin 1981. Ju e dini që në Kosovë kishte demonstrata përmes të cilave populli shprehu pakënaqësitë e veta dhe në to u intervenua në mënyrën më brutale, por kishte edhe vrasje. (Hysni Berisha, Shpresimi, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të përgjigjet në pyetjen se për se ndodhen krimet

A nuk do i shtrojnë ata të cilëve iu përkushtuam gjithë këtë, të cilët këto do i lexojmë, pyetjen – përse u vranë ata njerëz në Srebrenicë, përse u vranë ata njerëz në Vukovar? Kush do iu jep atyre përgjigjen në këto pyetje? Prapë do të iu japin këto pushtete të cilat do të shkruajnë librat e historisë njëjtë si edhe tani, më kuptoni plotësisht të ndryshme në të gjitha shtetet, në këtë unë shoh problemin. Do të thotë, shtrohet pyetja në mënyrë logjike – përse ajo ndodhi? (Sonja Radošević, gazetarë e lirë, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Duhet të vërtetohen shkaqet në mënyrë që të mos ndodhin konfliktet në të ardhmen

(...) Ne duhet t'i zgjidhim të bisedojmë për shkaqet në mënyrë që në të ardhmen të mos ndodh që duhet përsëri të merremi me faktet për konfliktin e ri në të ardhmen. (...) vërtetë mbajmë përgjegjësi, ne tani, në këtë moment, për gjithë atë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. (Mirjana Bilopavlović, Delfin, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Për shumë krime akoma nuk dihen dhe trajtohen si sekret publik. Në çfarë mase KOMRA do të merret me sekrete publike.

(...) Në Kroaci, akoma, ekzistojnë fakte të pa konfirmuara lidhur me vrasjet e shumta masive, vrasjet e serbëve për të cilët nuk dëshirohet të flitet. Unë, tani shtrojë këtë pyetje – kur do flasim për komisionet, a do i theksojmë edhe ato për çfarë nuk dihet, dhe për se njerëzit frikohen të flasin për atë. Kjo do të thotë në një rreth të ngushtë, por kur duhet të dilet në opinion, informata nuk kemi, akoma frikësohem për sigurinë e vetë personale, për sigurinë e fëmijëve të tyre, ose frikësohem mu nga gjykimi i bashkësisë (...) mua, thjeshtë më intereson se në çfarë mase komisioni do të merret me sekrete publike. (Mirjana Bilopavlović, Delfin, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Duhet të arsyetohen shkaqet e krimeve. Në të kundërtën, del që në konflikte të gjithë ishin në të njëjtën pozitë, çka në të vërtetë nuk ishin

Mendoj që, edhe më tutje, në fokus duhet të jenë viktimat, dhe faktet, por në këtë kontekst duhet arsyetuar edhe situatën e cila i ka paraprirë, përse fare erdhi deri te ajo. Nëse nuk e bënë këtë, atëherë të gjithë jemi të njëjtë. Ndërsa, unë mendoj që nuk jemi të gjithë të njëjtë. E dini, realisht mendoj dhe në atë kam besim të thellë se në këto konflikte nuk ishin të gjithë në pozitë të njëjtë. (Veljko Vičević, Radna grupa za promicanje dijaloga s braniteljima, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Vërtetimi i fakteve do të thotë vërtetimi i të gjitha rrethanave lidhur me krimin konkret

Ndoshta nuk kuptohemi në atë se çka janë faktet. Bile, nuk ishte as ide e imja, por nuk e di se a është edhe ide tjetër e ndokujt se fakte janë ato që – në Srebrenicë u vranë 7.000 njerëz, dhe pikë. Jo, çfarë na duhet komisioni për gjëra të tilla? Faktet janë diçka tjetër. Duhet të vërtetohet një ngjarje konkrete dhe të vërtetohen edhe të gjitha faktet që ndërlidhen me atë ngjarje. Kjo nënkupton për Srebrenicën se përse ata njerëz u vranë. Do të thotë, duhet të vërtetohet fakti se ata njerëz u vranë për shkak të përkatësisë së tyre fetare. Këtu fare nuk ka kontest. Kur flitet për atë që të vërteton faktet, kjo nënkuptohet, siç është fakti se urdhri erdhi nga gjëkundi, prandaj nga po ajo anë erdhi edhe urdhri, këtë do e vërtetojë edhe KOMRA, dhe ja ky është fakti i cili ndërlidhet me krimin në Srebrenicë. (Dragan Popović, iniciativa mladih za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Në vend të përzënies, duhet të thuhet përndjekjes, si formë e krimit kundër njerëzimit.

(...) Kemi anashkaluar për ndjekjen si formë e krimit kundër njerëzimit. Në luftën e kaluar përndjekjet ishin format më të shpeshta të krimit dhe nuk ka kuptim të anashkalohet ai krim. Përzënia, kjo nuk është përndjekje, as në variantet serbe, as në variantin boshnjak, dhe as në atë të gjuhës kroate. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të vërtetojë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të konventave të Gjenevës, por jo dhe të drejtave të njeriut

(...) Në fillim të këtij paragrafi duhet thënë se komisioni është marrë me vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkelje të konventave të Gjenevës, në vend të të drejtave të njeriut. Nëse dëshirojmë për të drejtat e njeriut, atëherë ajo është një gjerësi shumë e

madhe dhe KOMRA asnjë herë nuk do të arrijë që ti përfshijë të gjitha. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Autorizimet e KOMRA-së duhet të jenë të rregulluara me kontratë ndërkombëtare, ndërsa shtetet nënshtruese do të harmonizojnë legjislacionet e tyre me këtë kontratë

Mendoj që është më së e natyrshme që të bisedohet, qysh tani, që kjo çështje (autorizimet e KOMRA-së) të rregullohet me kontratë ndërkombëtare ndërmjet shteteve nënshtruese dhe pastaj kontrata e tillë ndërkombëtare të ketë fuqinë ligjore më të fuqishme se sa ligjet e vendeve nënshkruese dhe, thjeshtë, do të jenë të detyruara që të harmonizojnë legjislacionet me atë kontratë ndërkombëtare. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Ne, për të bërë diçka që do të ishte e qëndrueshme, unë jam plotësisht i pajtimit me kolegun se do të duhej që të hartohet një dokument ndërkombëtar, a do të ishte ajo konventë, protokoll ose kontratë ndërkombëtare, të cilin do e miratonin, veç e veç, të gjitha parlamentet, dhe me verifikimin e dokumentit nga ana e parlamentit, ai do të fitonte fuqinë e dispozitave vendore, të rregullave nacionale, dhe se ajo do të shpallej në gazetatat zyrtare apo fletët zyrtare, në atë mënyrë që do të ishte dispozitë e obligueshme për të gjitha strukturat në shtetin e caktuar. (Teki Bokshi, Oda e avokatëve të Kosovës, Kosovë. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Marrja dhe shkatërrimi i pronës në përmasa të mëdha nuk duhet të jetë në mandat, sepse do e ngarkoj punën e KOMRA-së, mirëpo mobilizimi i dhunshëm i të përndjekurve duhet të jetë brenda mandatit

(...) Nuk jam i sigurt për marrjen dhe shkatërrimin e pronës nëpër masa të mëdha. Nuk jam i sigurt që ajo duhet të futet, sepse ajo atyre njerëzve (anëtarëve/anëtareve të KOMRA-së) do iu ngarkojë një punë jashtëzakonisht të rëndë unë, gjatë gjithë kohës, thjeshtë kam në mendje një mandat të kufizuar, një lëmi shumë të gjerë të cilin ata e hulumtojnë, katër luftëra, gjithmonë duhet të mendojmë në atë se a do të mund të arrijmë diçka apo jo, kështu që unë, personalisht, nuk jam për atë, por (...) jam sa i përket mobilizimit të dhunshëm të të përndjekurve. Mendoj se kjo mund të futet në atë mandat, dhe kjo nuk do të zgjeronte në mënyrë të dukshme. (Dragan Popović, Inicijativa mladih za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Marrja dhe shkatërrimi i pronës në përmasa të mëdha është theksuar sepse njerëzit kanë mbetur pa pronën e tyre në tërësi

Unë vetëm dëshiroj të them se disa njerëz viktimat e luftës në atë mënyrë kanë mbetur pa pronën e tyre. Neve, atë mund ta anulojmë. Në fund të fundit, ndoshta disa kanë mbetur

edhe pa të drejtën banesore. Thjeshtë, nuk iu është shkatërruar prona, por ata kanë mbetur pa të drejta. (Zvonko Ninkov, Linet, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk duhet të merret me kualifikimet juridike

Ne kemi Tribunalin penal ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, kemi gjykatat nacionale, është e tyre që të kryejnë kualifikimet juridike për veprat e kryera (...) ndërsa unë, personalisht, kam përshtypjen se edhe një numër i madh i pjesëmarrësve në debat, gjithashtu, ka paraqitur atë mendim, dhe janë të mendimit që komisioni nuk duhet të merret me kualifikimet juridike. (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me shkeljen e të drejtave të njeriut, sepse 1500 kidnapime, të humbur dhe vrasje të serbëve dhe shqiptarëve lojal pas qershorit të vitit 1999 nuk trajtohen si krime lufte, duke marrë parasysh se janë kryer pas konfliktit të armatosur

(...) Kur kemi thënë komisioni për faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, atëherë ajo është në bazë të asaj që një numër i pjesëmarrësve, dhe kjo para se gjithash ka të bëjë jo vetëm me serbët nga Kosova, por edhe me ata të cilët merren me të drejtat e njeriut të cilët konsiderojnë që ai komision do të duhej të merrej me kidnapimet, të humburit dhe vrasjet e serbëve dhe shqiptarëve lojal pas qershorit të vitit 1999, për shkak se në periudhën deri në vitin 2000, kishte mjaft kidnapime dhe vrasje të shumta dhe se ato nuk mund të trajtohen si incidente, por ishin në një numër të madh, afro 1500 raste, kështu që komisioni nuk mund e të mos merret me ato shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Këto nuk janë krime lufte për shkak se nuk ishte koha e konfliktit të armatosur. (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mandati duhet zgjeruar edhe në veprat të cilat nuk janë krime lufte – në plaçkitje, në vrasje të cilat nuk janë krime lufte

Këto ishin luftëra plaçkitëse (...) kanë larguar nga ky (propozim) i ri plaçkitjen, ndërsa shumë krime mu për shkak të plaçkitjes kanë humbur (...) që të zgjerohet pak sa kjo edhe në vrasjet të cilat nuk janë krime lufte. (Miodjub Vitorović, Specijalno tužilaštvo za ratne zločine, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të ketë kompetenca urdhërdhënëse, sepse pa urdhër, komisioni do të ishte organ fakultativ i cili në esencë nuk do të mund të bënte asgjë

Nataša këtu ka iniciuar çështjen se, ata, a do ti respektojnë urdhrat nëse ky komision do të kishte kompetenca urdhër dhënëse, a do të vepronin organet e shtetit përkatës (...) edhe në ditën e sotme neve na ndodh çdo ditë në punën tonë që organet e caktuara për shkaqet e caktuara nuk veprojnë dhe nuk respektojnë urdhrat e gjykatave dhe prokurorive, por ne, prapë se prapë, edhe më tutje ekzistojnë, kështu që ajo nuk duhet të jetë shkak që të heqim dorë nga ndonjë urdhër. Sepse pa urdhra të tillë, ky komision do të ishte organ fakultativ i cili në esencë nuk do të mund të bënte asgjë. (Teki Bokshi, Oda e avokatëve të Kosovës, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk duhet të ketë autorizime për dhënien e urdhrave të obligueshëm

Lidhur me urdhrat e obligueshëm. Definitivisht konsideroj se duhet të vlen opsioni 2, për shkak se është një shembull praktik nga Maqedonia, prej nga vijë, ishte një tentim që të ndryshohet Ligji për procedurën penale dhe që të jepen autorizime prokurorisë për dhënien e urdhrave të obligueshëm. Kjo nuk kaloi, e ku atëherë autorizimet e tilla t'i jepen KOMRA-së. (Nataša Stamenkovik, MOZAM, Makedonija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Bartja e kufomave mund të evidentohet nën humbje të dhunshme

(...) Bartja e kufomave do të mund të evidentohet nën humbje të dhunshme. (Zvonko Ninkov, Linet, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Lista e shkeljes së të drejtave është e shkurtër

Nuk mundohem që të zgjeroj listën e shkeljeve të cilat janë dhënë në dokument, por mendoj se lista është e shkurtër. Për shembull, në Kosovë kishte shkelje të ndryshme e të drejtave. E drejta, e drejta në shkollim, e drejta në informim, e drejta në punë, kishte edhe shkelje tjera e të drejtave dhe presione të tjera të cilat nuk ishin shkaktar i drejtë për së drejtë i asaj çfarë ne kishim në Kosovë në vitet '99, por i kontribuonin atyre në mënyrë indirekte. (Nehari Sharri, Forumi ZFD, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret edhe me shkaqet

Disa pohuan se është e rëndësishme vetëm ajo çfarë ka ndodhur, mirëpo un mendoj se është e rëndësishme se si, kur ndodhi ajo. Kjo shkon në pako. Ky është një pako e kompletuar faktesh (...) faktikisht, do iu lenim gjeneratave të ardhshme diçka të pa

zbuluar. (Nehari Sharri, Forumi ZFD, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me të “shlyerit” nga Sllovenia

(...) Meqenëse mua më kishte mbetur shumë që Sllovenia të ishte e kyçur në atë proces, meqenëse ishte njëra prej pjesëve përbërëse të Jugosllavisë, meqenëse aty kishte banorë të cilët ishin viktimë dhe të cilët kishin kryer krime (...) ata ishin viktimë të shkeljeve të veçanta të të drejtave të njeriut të cilat ndoshta akoma edhe nuk kishin emra si krime, por unë mendoj se do të duhej të vendosem në atë kontekst dhe që do të duhej të iu jepej edhe emri, ndoshta në procesin e vetë komisionit. Tani unë flasë në mënyrë specifike, të themi për rastin e të shlyerve ku kishte në disa mijëra, më shumë se 20.000, 28.000 njerëz, dhe të cilët ishin viktimë të një krimi i cili do të mund të quhej krim administrativ. (Vlasta Jalusić, Mirovni institut, Slovenija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

(...) shlyerja nuk ishte vetëm një gabim thjeshtë administrativ, por kishte edhe një moment etnik sepse me atë konkretisht janë shlyer njerëzit të cilët kishin qëndrim të përhershëm në Slloveni. Nuk kishin shtetësinë e Republikës së Sllovenisë, por njërën prej shtetësive republikane të republikave tjera jugosllave. Për shembull, me atë vendim për shlyerje nuk ishte i cenuar qëndrimi i përhershëm i asnjërit prej shtetasve të huaj, Anglez, Francez (...)konkretisht shlyerja ka cenuar ekzistencën e shumë njerëzve, jo vetëm me atë që i kanë humbur të drejtat, që disa ishin edhe të deportuar etj., por me atë kanë humbur edhe të drejtën e qëndrimit dhe nuk kishin shtetësinë e asnjë shteti, ata u bënë njerëz të pa ekzistueshëm të cilët i humbën të gjitha të drejtat sociale, sigurimin e tyre social çka derivoj që pjesa më e madhe e popullsisë së shlyer të përjetojnë probleme serioze shëndetësore të cilat nuk mund të shëroheshin, mu për këtë shkak sepse kanë ekzistonin jashtë sistemit. (Jovana Mihajlović- Trbovc, Mirovni institut, Slovenija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Unë vetëm do të kthehesha te titulli (emri), do të thotë komisioni regjional për vërtetimin e të gjitha fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda e të drejtave të njeriut në hapësirat e ish Jugosllavisë. Sipas kësaj që kemi marrë në pikën e parë, kjo më së voni fillon me një janar të vitit 1991. Të shlyerit janë sigurisht shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, Sllovenia është ish Jugosllavia dhe kjo ka ndodhë pas një janarit të vitit 1991. (Tihomir Ponoš, Novi list, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me të “shlyerit”

Problemi i të shlyerve është një problem administrativ, sipas meje. Nuk është problem i Kushtetutës së Republikës të Sllovenisë, nuk mund të jetë obligim i KOMRA-së që të merret me atë. (Pjesëmarrës i paidentifikuar).

Listën e krimeve duhet përshkruar nga Statuti i Romës

(...) jam i mendimit që do të duhej, bile atë listë të krimeve duhet specifikuar mu ashtu siç e shtron Statuti i Romës, përkatësisht ashtu siç është bërë në mënyrë elegante në ligjin e Bosnjës dhe Hercegovinës, thjeshtë është përshkruar Statuti i Romës dhe aty gjenden të numëruara të gjitha veprat dhe mendoj se është gabim më i vogël të bëhet një gjë e tillë, se sa të mos ofrohet lista e qartë për ata agjentët e ardhshëm, komisarët, (...) të cilët do të punojnë në terren. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me krimet që kanë ndodhur gjatë luftës, si pasoja të luftës dhe në kontekst të luftës

(...) mbështesë propozimin e koleges time që, realisht do duhej në preambulën e aktit themelor të KOMRA-së(...), të kyçet edhe ajo se KOMRA merret me krimet që kanë ndodhur gjatë luftës, si pasojat e luftës dhe në kontekst të luftës, dhe kjo do të ishte korniza më adekuate për aktivitetet e KOMRA-së. (Jovana Mihajlović- Trbovc, Mirovni institut, Slovenija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Në mandatin e KOMRA-së duhet theksuar forma konkrete të shkeljeve e të drejtave të njeriut, por duhet mbajtur edhe dispozitën se Komisioni merret edhe me format tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut.

(...) mendoj që komisioni në Peru ka numëruar format e shkeljeve të rënda e të drejta të njeriut dhe në fund kanë përfunduar të numëruat, në mënyrë konkrete dhe në fund qëndron edhe forma të tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut. Do të thotë, ajo që nuk është përfshirë, me këtë mund të jetë edhe e përfshirë, çka nuk është numëruar. (Sonja Radošević, gazetarë e pavarur, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Problemi i kampeve të internimit (llogoreve) dhe i të internuarve duhet të gjendet në mandatin e KOMRA-së

(...) për mua është e frikshme që të mos futet edhe problemi i kampeve të internimit (llogoreve) dhe i të internuar si dhe të gjitha ato vuajtje të llahtarshme, kjo është diçka krahas vrasjeve masive, e që, sipas mendimit tim, do të duhej të gjendej në mandatin e KOMRA-së. (Sonja Radošević, gazetarë e pavarur, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nëse mbetet zgjidhja që KOMRA nuk do të jep kualifikime juridike, a ka të bëjë kjo vetëm në atë që do ta hulumtojë vetë komisioni, ose do të thotë edhe pamundësi për marrjen e kualifikimeve juridike nga aktgjykimet e Tribunalit të Hagës?

(...) ndër të tjera thuhet që komisioni nuk do të jep kualifikime juridike për krimet dhe shkeljet e theksuara, por që do të prezantojë fakte mbi ngjarjet me të cilat janë kryer shkeljet. Ajo që ishte dilemë, dhe që unë e kam kuptuar si dilemë, është se ekziston një rezistencë në disa shtete që në raportin të cilin do ta hartojë komisioni, të hyjnë edhe aktgjykimet e Tribunalit të Hagës. Do të thotë, ajo që thuhet lidhur me kualifikimet juridike, ka të bëjë vetëm me atë që do të hulumtohet nga KOMRA, ose ka të bëjë edhe me aktgjykimet e Tribunalit të Hagës, çka do të nënkuptonte se nuk mund të qëndrojnë se në Srebrenicë është kryer gjenocid nëse pranohet (...) mendoj se kjo duhet sqaruar. (Sonja Radošević, gazetarë e lirë, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Fshehja e fakteve për krimet, siç janë të humburit, duhet të jetë lloj i veçantë i shkeljeve

Sa i përket trupave e të humburve (...), unë jam pjesëtarë i familjes që ka humbur 48 anëtarë në Suharekë, trupat e të cilëve akoma nuk janë gjetur. Disa i kemi gjetur, por disa akoma deri më sot. Unë këtë nuk do e sistemoja në humbjen e dhunshme, por këtë do e sistemoja në fshehjen e fakteve të krimit. Do të thotë, kjo do të duhej sistemuar në fshehjen e fakteve të krimit. (...) kjo duhet të jetë pikë e veçantë, e llojit të shkeljes. (Hysni Berisha, Shpresimi, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mandatin duhet shtruar gjerësisht, sepse në fund politikat do të vendosin për mandatin e komisionit, dhe ata sigurisht do të limitojnë mandatin

(...) përveç që do të fusim në mandat të gjitha mundësitë e gjëra, në fund parlamenti ose qeveritë do të vendosin për atë. Sigurisht, politikat do të tentojnë që atë do e vendosim në një masë tjetër (...) prandaj, nëse shkojmë së tepërmi në gjerësi, atëherë do e lëmë mundësinë që ata, sigurisht, në marrëveshjet e tyre të e krasitin nga pak. (Veljko Vičević, Radna grupa za promicanje dijaloga s braniteljima, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nuk guxohet që nga aktgjykimet të merren vetëm faktet pa kualifikime juridike, sepse kjo do të thotë revidim të procedurave gjyqësore

Aktgjykimi i Gjykatës ndërkombëtare dhe gjykatave vendore, me të cilat është shqiptuar kualifikimi juridik, kurrsesi nuk guxon të ndodhë që KOMRA, vetëm nga ato aktgjykime, të nxjerrë faktet e caktuara, dhe të mos e përdorë kualifikimi juridik. Kjo, thjeshtë, do të ishte revidim proceseve gjyqësore. (Dževat Bektašević, Udruženje porodica žrtava rata

Vlasenica 1992 – 1995, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

(...) sikur KOMRA të përdorte aktgjykimet (Tribunali i Hagës) pa kualifikime, pa kualifikime juridike, atëherë do të thoshte që KOMRA e ndryshon aktgjykimin, dhe nuk është i autorizuar për atë, sepse aktgjykimet e ICTY janë përfundimtare. (Nataša Stamenkovik, MOZAM, Makedonija,. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nëse KOMRA nuk merret me kualifikimet juridike, atëherë nuk ka as revidim

(...) revidim do të ishte atëherë kur KOMRA do të pohonte se ajo çfarë është bërë në Srebrenicë nuk është gjenocid, ky është revidim. Mirëpo, nëse KOMRA fare nuk do të merrej me kualifikimet juridike, atëherë nuk ka as revidim. Do të thotë, nuk ka fare autorizime gjyqësore. (Dragan Popović, Iniciativa mladih za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të grumbullojë fakte, dhe atë në formularë standard, ndërsa gjykatat do të japin kualifikime juridike

(...) prandaj, ne (KOMRA), do të grumbullojmë faktet. Ndërsa, gjykatat janë ato që do të shqiptojmë kualifikimet. Prandaj, puna jonë themelore është grumbullim i fakteve, siç pohojë kolegu nga Zagrebi, në formularët standardë, në mënyrë që çdo njeri i zakonshëm do të mund ta bënte. (Slavko Kecman, Udruga zam ir Bilje, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Në raportin e KOMRA-së, patjetër duhet të hyjë kualifikimi i Tribunalit të Hagës

Ne grumbullojmë (KOMRA grumbullon) faktet, por është fakt se Gjykata ndërkombëtare (Tribunali i Hagës) e ka kualifikuar këtë si gjenocid në Srebrenicë, a është kështu? Do të thotë absolutisht ne nuk gjykojmë dhe grumbullojmë faktet të cilat, më vonë, do i dërgojmë në prokurori, ato do të merren me to. Mirëpo, unë flasë për aktgjykimet të cilat tani më janë marrë dhe të cilat Gjykata ndërkombëtare penale (Tribunali iHages) i ka nxjerrë. Do të thotë, unë jam i mendimit që ato pa tjetër duhet të hyjnë në raportin e KOMRA-së. (Sonja Radošević, gazetarë e pavarur, Mali i Zi. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nëse KOMRA, nesër do të gjendet në terren për të vërtetuar faktet, për shembull kush ka udhëhequr, kush ka komanduar me “Drinski korpus”, në kohën kurë ishte marrë Zona e mbrojtur e Srebrenicës. Atëherë, do të thoshte se nuk kemi nevojë të konfirmojmë atë, sepse atë e ka konfirmuar gjykata në Hagë, se ai ishte gjenerali Krstić, dhe ai është

gjykuar me vendim të plotfuqishëm. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Aktgjykimet e Tribunalit të Hagës janë të dobishme për gjetjen e kryesve të drejtpërdrejtë të krimeve

(...) duhet, saktësisht, të individualizohen faktet në raport me kryerësit. Prandaj, në atë masë janë të rëndësishme edhe aktgjykimet e Gjykatës ndërkombëtare në Hagë që, thjeshtë, të na ofrojnë një mbështetje që të shkojmë sa më thellë, deri te kryerësit e drejtpërdrejtë, ti hulumtojmë ata, t'i vërtetojmë faktet të cilat mund të inkriminojnë kryerësit e drejtpërdrejtë. (Ibro Bulić, Tužiteljstvo BiH, BiH. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të përcjellë gjykimet për krimet e luftës dhe të shpallë komunikata lidhur me ato gjykime

(...) drejtë për së drejtë, e tëra kjo, është e ndërlidhur me aktgjykimin e Gjykatës supreme të Kroacisë, me të cilën Norcit i është zvogëluar dënimi nga 7 në 6 vjet dhe është vërtetuar lirimi për Ademin. Unë konsideroj që KOMRA, për çdo rast, në të ardhmen duhet përcjellë gjykimet. Atë nuk e kam parë këtu, dhe të jep opinionet, si dhe komunikata lidhur me atë. (Dragan Pjevač, Udruženje porodica ubijenih i nestalih lica u Krajini i Hrvatskoj, Srbija. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Në mandatin e komisionit duhet të gjendet dhe propozimi për lirimin e personave të gjykuar, ose zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, por duhet të gjenden mundësi për falje edhe për kryerës të caktuar të veprave penale

Nuk do të pajtohesha edhe aq që KOMRA mund të propozoj lirim me kusht për persona të gjykuar, nuk do të pajtohesha edhe për atë që KOMRA mund të propozojë zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (...) mund të pajtohem që të propozojë falje për kryerës të caktuar të veprës penale nëse për komisionin sigurohen informata të një rëndësie të veçantë, edhe me atë rast shprehet pendim dhe kërkim falje ndaj viktimave. (Mevludin Lupić, Udruženje porodica zarobljenih i nestalih lica Općine Zvornik, BiH. Forumi i gjashtë regional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Komisionit nuk do t'i lejohet që të ndërhyjë në punën e trupave gjyqësore

*(...) juve askush nuk do të ju lejojë, gjegjësisht neve, që ne me punën tonë të ndërhyjmë në punën e trupave gjyqësore. Ata do të lejojnë që ne të jemi një lloj trupi ndihmës, thënë kushtimisht, por që të ndërhysh në punën e tyre, ajo çfarë paraqet esencën ose **meritum**, kjo s' do të ketë shans. (Pjesëmarrës i paidentifikuar).*

Sipas propozim mandatit të tanishëm KOMRA rrezikshëm do të ndërhynte në legjislaturën penale dhe procedurale.

(...) un, asgjë nga kjo nuk do e vendosja, e tëra kjo që është ofruar, për komisionin në procedimin penal. Përse nuk do e vendosja? Mendoj se diçka nga kjo është pak si ndërhyrje e rrezikshme në legjislaturën penale dhe procedurale. Ajo për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe lirimin me kusht të personave të gjykuar, kjo paraqet mu atë që nënkupton ndërhyrje në legjislaturën penale procedurale (...) nuk vërejë qëllimin e kësaj, sepse për çdo rast KOMRA nuk mundet askënd të lirojë, nuk mundet askujt t'i ia zvogëlojë dënimin, do të thotë nuk mund të shtyj as prokurorinë dhe as gjykatat të bëjnë çfarë do çoftë (...) vetëm që atëherë do të arrihet deri te një lloj konfuzioni që njerëzit të presin diçka të tillë, që t'i lirojë KOMRA, t'i falë, të iu zbutë dënimet jashtëzakonshëm (...) nëse diçka do të pohonin për ndërrim, atëherë edhe do presim që do të fitojmë diçka nga ai ndërrim. KOMRA mund të i propozojë gjykatës. Prandaj them, dhe mendoj që kjo nuk ka kuptim (...) nuk do i veja as fletëparaqitje penale, sepse atëherë dikush në komision mund të merret me përpilimin e fletëparaqitjeve penale. Mendoj që është më mirë që KOMRA, thjeshtë, të gjithë dokumentacioni të ia dërgojë prokurorisë, dhe le të punojnë prokuroritë. Përse do të lodhesha tani të merrem me hartimin e fletëparaqitjeve penale? (Dragan Popović, Inicijativa maladih za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Mandati i KOMRA, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Marrëveshja ndërshtetërore duhet të obligojë çdo nënshkruese që të hap arkivat

Marrëveshja ose kontrata ndërshtetërore, si do që të quhej, duhet të obligojë çdo njëerë nënshkruese që të hap arkivin. Këtë vërejë një urdhër obligativ, prandaj, të gjitha shtetet të cilat hyjnë në organizatën e konstituimit të komisionit regjional për tu ballafaquar me të kaluarën, automatikisht, me një pjesë të kontratës do të jetë e rregulluar që të gjitha arkivat të cilat ekzistojnë në atë shtet, të jenë të hapura dhe në disponim të komisionit, në mënyrë që i njëjti ato t'i shfrytëzojë. Mendoj, pa këtë, është tërësisht iluzore që të kryhet puna për tri vite. (Pjesëmarrës i paidentifikuar).

Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë

**Novi Sad, Serbi
20 mars 2010**

Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM)

Propozimet, opinionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve:

Të hartohet lista e të gjitha viktimave dhe të gjitha krimet të sillen para gjyqit

(...) është i mjaftueshëm të theksohet vetëm formulimi (...) të hartohet lista e të gjitha viktimave dhe të gjitha krimeve, dhe të gjitha krimet të sillen para drejtësisë. Prandaj, kjo do të thoshte të kuptuarit e të vërtetës, prandaj ballafaqimi me të vërtetën dhe shkuarja në gjykatën e drejtësisë me ata të cilët janë fajtorë për atë. (Draško Bjelica, Filozofski fakultet u Nišu, Srbija, Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Duhet bërë integrimin në mes të vërtetës juridike dhe të dokumentuar. Nuk mund të vërtetohet e vërteta historike

Çfarë e vërtete është e mundur që vetëm të vërtetohet? Vetëm e vërteta juridike. Mos bëni gabim që ne laikët në bazë të profesionit, mund të vërtetojmë të vërtetën historike. Për të vërtetën historike është e nevojshme që të hapen arkivat, dhe, është rregull i artë se duhet të ekzistojë rrjedha kohore, e cila në shkencën e historisë definohet si 50 vjeçare (...) në elementin cila e vërtetë, duhet bërë integrimi në mes të të vërtetës juridike dhe asaj të dokumentuar, nga shkak se komisionet për të vërtetën nuk janë gjykata dhe nuk mund të nxjerrin aktgjykime, por mund të formojnë qëndrime. Qëndrimin mund ta formoni vetëm nëse keni dokumente të vlefshme. (Branislav Radulović, Udruženje pravnika Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.).

E vërteta politike nuk është edhe e vërteta, ajo është qëndrim. Duhet të shkohet në të vërtetën e dokumentuar, sepse ka bazë juridike

(...) ne nuk guxojmë të hyjmë në vërtetimin e të vërtetave politike. E vërteta politike nuk është edhe e vërteta, ajo nuk është e vërteta, e vërteta politike është qëndrim dhe e drejtë e çdo kujt që, si i tillë, ka qëndrim të caktuar (...) unë konsideroj se duhet shkuar në të vërtetën e dokumentuar, do të thotë e cila disponon bazueshmërinë juridike gjegjëse, por nuk është gjykatë, të tjerat të fshihen. (Branislav Radulović, Udruženje pravnika Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Pajtimi dhe pendimi është i rëndësishëm për shkak të njerëzve të rinj

(...) Pajtimi në mes të gjitha gjeneratave, pendimi në mes gjeneratave të cilët janë aktor dhe bartësit e të padrejtës dhe krimet, dhe posaçërisht për njerëzit e rinj. I kam thënë një herë një mikut tim nga Kosova dhe Metohija, nuk dëshiroj që vajza ime nesër të urrejë djalin ose vajzën tuaj. Jo, ejani që ne këtë ta tejkalojmë, dhe që ata të jetojnë në paqe dhe të jetojnë si çdo botë normale në Evropë dhe gjithë botën. (Milosav Stojković, Centar zaštite porodica žrtava rata na KiM, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Kryerja e ekshumimeve duhet të hyjë në plan të parë të KOMRA-së

Komisionet qeveritare, para neve prindërve dhe familjeve (të personave të humbur), arsyetohen se nuk janë në gjendje që të hapin ato varreza dhe të bëjnë ekshumimin për shkak të asaj se Institutet e DNK janë të stërngarkuara dhe nuk kanë mjaft ngrirës të thellë për ta bërë ekshumimin, një arsyetim të tillë askush prej familjeve dhe shoqatave nuk e pranon, sepse me këmbëngulje kemi kërkuar që të blihen ngrirësit e thellë nëse janë pak, tri shtete ndoshta do të mund ta bënin, nëse nuk munden, atëherë mund ta bëjë Bashkimi Evropian, bile edhe Kombet e Bashkuara (...) për këtë shkak, lutem që edhe kjo të hyjë në planin e KOMRA-së. (Dragan Medić, Udruženje roditelja i porodica uhapšenih, zarobljenih i nestalih lica SRJ 1991 i 1992. godine, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qëllimet themelore të KOMRA-së janë vërtetimi – të vërtetës, të drejtës, pajtimi

Qëllimet themelore të KOMRA-së mendoj që tani më janë vërtetuar, thënë shkurtimisht e vërteta, e drejta, pajtimi. (Persa Vučić, Zene u crnom, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Me rastin e analizës së ngjarjeve të shfrytëzohet edhe arkivi i Tribunalit të Hagës

(...) pa arkivin e Tribunalit të Hagës, pa proceset të cilat (...) janë zhvilluar para Tribunalit, praktikisht është e pa mundur të punohet, dhe është propozim i yni, gjegjësisht propozim i “Savez logoraša Bosne i Hercegovine” është që nëse dëshirohet të merremi me këtë problematikë në hapësirat e Bosnjës dhe Hercegovinës, për secilin rast, të shfrytëzohet edhe ajo pjesë e arkivit me rastin e analizës së ngjarjeve. (Murat Tahirović, Savez logoraša BiH, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mund të arrijmë në rrezik ndarjeje me rastin e vërtetimit të qëllimeve

Nëse KOMRA do i vërtetojë faktet, atë e bëjnë gjykatat, nëse do të hulumtojë shkaqet, atë e bëjnë institucionet profesionale të cilat disponojnë me kuadro për atë. Kam frikë se

nëse zgjerohemi aq shumë, që të shkojmë në ballafaqim me të vërtetën, në vërtetimin e fakteve, në vërtetimin e përgjegjësive, në vërtetimin e shkaqeve, kam frikë se ne nuk do të përgjigjemi në kërkesa të tilla aq të larta. (Salih Resavac, Corridor, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

REKOM duhet të fokusohet në viktimat. Është pretencioze të flitet për pajtimin

Kur është fjala për atë se e kujt është e vërteta, unë konsideroj që KOMRA duhet të jetë i fokusuar në viktimat. Ne, gjer tani, kemi pasur një numër të madh të të vërtetave grupore dhe manipulimeve, prandaj për këtë shkak është e rëndësishme që ata që kanë vuajtur më së shumti në luftë në hapësirat tona, t'i vejmë në plan të parë. (...) unë nuk mendoj që duhet të jem aq pretencioz dhe të flasim për pajtimin. (Borka Rudić, BH novinari, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Viktimat duhet kompensuar

(...) krahas vërtetimit të të vërtetës dhe shkaqeve, është e domosdoshme që viktimat (...) të kompensohen për atë çfarë ju është bërë. Në çfarë mënyre do të paguheshin ato reparacione mbetet si çështje. (Bojan Gavrilović, Beogradski centar za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Të gjitha viktimat duhet të jenë të barabarta

(...) Nëse nuk mbani llogari që të përfaqësoni këto viktimat, të gjitha njësojë dhe që të katërtat, sa neve jemi, pesë kombe të cilat kemi pësuar në luftën e kaluar, unë besoj që KOMRA nuk do të mbijetojë. (Smilja Mitrović, Savez udruženja nestalih Republike Srpske, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me të vërtetën juridike dhe të dokumentuar

(...) sigurisht se do të ishte përkatëse dhe më efikase që të ndalemi në të vërtetën juridike dhe të dokumentuar, ndërsa e drejta politike dhe historike, nëse ne merremi me të vërtetën juridike dhe të dokumentuar, ne do të dokumentojmë krimet e luftës, dhe kjo automatikisht do të krijojë të vërtetën historike. Mirëpo, nëse ne merremi me të gjitha të pestat, bile dhe me të vërtetën politike dhe historike, kjo do të kërkojë shumë kohë të gjatë. (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Kërkim falja duhet të jetë qëllim i KOMRA-së

Është e rëndësishme që definitivisht të theksohet kërkim falja, sepse shoqëria civile ka kërkuar që kjo të futet në mandate (qëllime), të KOMRA-së (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

“Dalja nga rrethi vicioz i dhunës” është faza të cilën e kemi tejkaluar

(...) në Kosovë lufta ka përfunduar para 10 viteve, kështu që mendoj se pika 3, “dalja nga rrethi vicioz i dhunës”, është faza të cilën tani më e kemi tejkaluar. (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Duhet bërë regjistrimin e viktimave dhe kryerësve të krimeve

(...) duhet të emërojmë dhe të bëjmë regjistrimin e viktimave, njëkohësisht dhe kryeseve të krimeve, nën numrin një. Në dy, duhet t'i ballafaqojmë, të ballafaqojmë të gjallët, ndërsa të dënojmë kryerësit dhe në atë mënyrë që do iu heqim oreolin, sepse para popullit të vetë po paraqiten si hero. (Zaim Elezi, Perspektiva më e mirë, Kosovë. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qëllimi i KOMRA-së që të mbajturit në mend e gjakut të shndërrohet në bashkëndjesi dhe falje

Duhet që përmes medieve të theksohet e vërteta përmes viktimave, në mënyrë që ai presion, ai ballon presioni të lëshohet përmes “ventilit” dhe që në mbajtja në mend e gjakut të shndërrohet në bashkëndjesi dhe falje. Këtë e bënë KOMRA dhe ky është qëllim i KOMRA-së. (Nataša Stamenkovik, MOZAM, Makedonija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

(...) dëshmitë e viktimave mund të kontribuojnë në pajtim dhe që ai është mesazhi, ajo forcë të cilën opinionin mund ta njohë dhe që përmes tij mund të përjetohet katarza, ku do të shihet e gjithë pakuptimësia e luftërave, që edhe kombet tjera kanë përjetuar vuajtje të njëjta. (Bojan Gavrilović, Beogradski centar za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Është e nevojshme që të krijohet një ambient në të cilin do të jetë bashkëndjesia dhe solidariteti me viktimat nga radhët e grupeve tjera etnike

(...) në këtë shkallë (...) të procesit konsultativ, do të thosha se mbisundon interpretimi vijues i pajtimit, si qëllim i komisionit regjional. Që është e nevojshme të krijohet një

ambient në të cilin do të ketë bashkëndjesi në viktimat nga radhët e bashkësive tjera etnike dhe të ekzistojë solidariteti me viktimat nga bashkësitë tjera, dhe ata të mos të shikohen si armiq. (Nataša Kandić, Fond za humanitarno pravo, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk mund të gjykojë

(...) të vërtetën juridike mund ta vërtetojë vetëm gjykata, gjykata ndërkombëtare, gjykatat lokale (...) a mundet KOMRA të gjykojë, a mundet KOMRA të jetë gjykatë? Do e jap qëndrimin tim personal – Jo. (Branislav Radulović, Udruženje pravnika Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM)-it, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nuk mund ta shkruajmë histori, por jemi të obliguar të lëmë pas veti dokumente

(...) historinë nuk e shkruan gjenerata e cila ka krijuar ngjarje, historia shkruhet nga një distancë historike. Ne nuk mund të shkruajmë histori. Ne mund të lëmë pas veti dokumente që të mos mbetet që dikur, kur dikush do të punojë nga aspekti historik i ngjarjeve, të mos ketë të dhëna mbi të gjitha viktimat, prandaj jemi të obliguar që prapa nesh të lëmë dokumentacione (...) nëse humbasim dokumentet, nuk do të ketë ngjarje, nëse nuk do të ketë ngjarje, nuk do të ketë fajësi, nëse nuk ka fajësi, puç pike, asgjë nuk ka ndodhur. (Branislav Radulović, Udruženje pravnika Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM)-it, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qëllim duhet të jetë transformimi i institucioneve

(...) detyrimisht duhet shtuar transformimin e institucioneve. Nëse gjykatat mbeten ashtu çfarë janë, ne nuk mund të arrijmë deri te ajo e vërtetë juridike, sepse gjykatat atrofojnë, pamundësojnë ose iu shmangen procedurave. (Branislav Radulović, Udruženje pravnika Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

“Shlyerja” nga regjistri i qëndrimit të përhershëm në Slloveni është krim

Ndodhi që në Slloveni, pas pavarësisë, u shlyen qytetarët të cilët nuk kishin marrë nënshkrimin e Sllovenisë nga regjistri i qëndrimit të përhershëm në Slloveni, dhe ky është një fenomen i madh në botë, dhe i dëshmuar se ishte jo ligjor, këtë e dëshmoi edhe Gjykata Kushtetuese (...) Qëllimi ynë është (...) që atë fenomen të shpallim si krim, dhe kryerësit të dënohen. (Nisveta Lovec, Civilna iniciativa izbrisanih aktivistov (CIIA), Slovenija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA duhet të merret me faktet dhe me shkaqet

A dëshirojmë të merremi me faktet apo me shkaqet? Edhe njëra edhe tjetra. (Kada Hotić, Pokret majki enklava Srebrenica i Žepa, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk do të ketë mundësi që të merret me kontekstin politik dhe historik

Kur them që vëmendja jonë duhet të mbahet në këtë, që të mos marrim kontekstin politik dhe historik, atëherë konfirmojë se ajo është një barrë e madhe për këtë tubim, përndryshe. Duhet të kalojë kohë, këtë e dëgjuam nga diskutantët, një periudhë, kur do të hapen të gjitha lëndët dhe ku gjërat do të vijnë në vend të vet, mirëpo tani ne nuk kemi atë mundësi, përsëris, kjo është një barrë e madhe dhe e rëndë për të gjithë neve. (Milosav Stojković, Centar Zaštite porodica žrtava rata na KiM, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

KOMRA nuk duhet të vërtetojë shkaqet

(...) vërtetimi i shkaqeve është me të vërtetë një çështje e rëndë, është e vështirë të vërtetohet se kush për çfarë është fajtorë, kush ka filluar dhe ashtu radhazi, dhe nëse ajo vërtetohet (...) mund të hedhë poshtë atë çfarë është vërtetuar, atë dokument si (...) të pavërtetë, për shkak se ai ashtu e konsideron (...) ekziston edhe një rrezik tjetër, që është Se do ti përkushtohet energji për së tepërmi në vërtetimin e shkaqeve, dhe ajo të mos sjellë deri te rezultati ose efekti i pritur, dhe çka më në fund edhe do të zvogëlojë projektin tonë në tërësi. (Bojan Gavrilović, Beogradski centar za ljudska prava, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Detyra themelore e KOMRA-së është që të gjejë metodat se si të arrihet deri te e vërteta e cila do të jetë e pranueshme për të gjitha viktimat

Mendoj që detyrë themelore e jona dhe e KOMRA-së është që të gjejmë rrugë dhe metoda se si të arrijmë deri te e vërteta e cila do të jetë e pranueshme për të gjitha viktimat dhe gjithmonë të ia japim emrin e vërtetë krimin dhe emrin e vërtetë viktimës. (Anđelko Kvesić, Hrvatska udruga logoraša u kantonu Središnja Bosna, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Nëse pajtimi është si qëllim tepër ambicioz, atëherë si qëllim të theksohet – ambienti, klima e tolerancës

(...) kur kam hyrë në këtë proces, pakëz më ka prekur ajo që disa njerëz u kundërvunë që të shlyhet pajtimi. Dhe unë kam thënë se përse, sepse unë kam hyrë mu për këtë shkak që t'i kontribuojë pajtimin. Ndoshta, nëse është pajtimi tepër ambicioz (...) thjeshtë të vihet (...) ambienti, klima e tolerancës, në të cilën, atëherë do të jetë e mundshme bashkëjetesa, do të mundësohet jeta normale. (Šefika Muratagić, Ključ budućnosti, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Mendoj që do të duhej punuar në të vërtetën dokumentare

Unë mendoj që duhet punuar në të vërtetën dokumentare, me grumbullimin e dokumenteve për gjithçka që ka ngjarë, do arrijmë edhe deri te shkaqet edhe deri te faktet. Do të thotë, vetë dokumentet, kur të jenë të grumbulluara dhe të sortuara, nga të njëjtit mund të shihet se çka ishte shkaku, çka ishte fakti dhe çka pasojat, dhe cilat janë viktimat. (Pjesëmarrëse e paidentifikuar. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Viktimat duhet të përcaktojnë prioritetet

(...) duhet të krijojmë prioritetet çka është më e rëndësishme dhe cilat janë ato aspekte të të vërtetës, unë kështu do i quaja më me dëshirë, se sa të vërteta, cilat për ne janë të rëndësishme, dhe kush jemi ne ata që jemi më të rëndësishmit. Në këtë rast, unë mendoj se jemi pajtuar që viktimat janë më të rëndësishmet, dhe se janë ato (...) që do të duhej t'i përcaktojnë prioritetet. (Lidija Zeković, Omladinski centar Postpesimisti Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Frikësohem se do të hapen plagët, dhe që nuk ekzistojnë institucionet të cilat do të ndihmonin në të rrëfyerit

Unë kam frikë që shoqëria ime dhe qyteti im nuk disponojnë kapacitete që të përgjigjen në problemet e viktimave të luftërave në vendin tim. Thjeshtë, kam frikë se të mos bëhet një hap që të hapen plagët, dhe të mos ekzistojnë njerëz, siç nuk ekzistojnë definitivisht institucione, të cilat do të iu ndihmojnë njerëzve që të përfitohet në këtë moment të të rrëfyerit, për të cilin gjithashtu u bë fjalë. (Lidija Zeković, Omladinski centar Postpesimisti Crne Gore, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitorë – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Duhet dokumentuar në proces publik

(...) mendoj që është qëllim që të dokumentohet, por jo në procesin e marginalizuar, por në proces i cili do të jetë (...) ndihmë për neve që të ballafaqohemi me atë çfarë ka ndodhur dhe (...) që të mund të shkojmë më tutje. Atë rolin e të rrëfyerit do e ritheksoja përsëri. (Ajša Hadžibegović, 35 mm, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qeveritë në regjion me vështirësi do e pranojnë komisionin i cili do të vërtetojë shkaqet, sepse ajo do të thotë vërtetimi i përgjegjësisë institucionale

(...) jam edhe për vërtetimin e shkaqeve (...), por, duke njohur situatën në regjion çfarë është momentalisht, jam skeptike në pikëpamje të asaj që qeveritë tona në regjion do të jenë të gatshme që të pajtohen me një komision të këtillë, thjeshtë nga shkak se (...) me këtë rast KOMRA do të vërtetonte një lloj përgjegjësie institucionale. (Sandra Orlović, fond za huanitarno pravo, Srbija, . Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Dëshnimet publike duhet të mbahen në numër sa më të madh dhe të transmetohen nga mediet

Duhet që dëshnimet publike të zgjerohen sa më tepër dhe të mbahen në numër sa më të madh (...) është me rëndësi se me këtë do të tregohet sa më shumë dhe sa më shpesh, sepse të gjithë ne do të vinim më lehtë deri te pajtimi dhe më shumë njerëz do të thirreshin në përgjegjësi. (Ljubiša Filipović, Udruženje porodica stradalih, ubijenih i nestalih na Kosovu i Metohiji, Crveni Božur, Crna Gora. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Është me rëndësi edhe e vërteta subjektive narrative, deri te e cila arrihet përmes dëshmimeve publike dhe shënimi i kujtimeve të njerëzve

Ekzistojnë dallime në mënyrën se si do të arrijmë deri te e vërteta. Krahas fakteve të së vërtetës, duhet edhe më shumë të respektohet e vërteta subjektive, do të thotë narrative. Deri te ajo mund të arrihet krahas këtyre dëshmimeve publike dhe përmes shënimeve nga kujtimet e njerëzve. (Svetlana Vuković, Centar za odgovornu demokratiju, Luna, BiH. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Pajtimi arrihet me të folurit e të vërtetës dhe fakteve mbi krimin e kryer

Pajtimi për mua mund të arrihet me foljen e të vërtetës dhe fakteve mbi krimin e kryer. Faktet me të vërtetë janë vuajtjet e viktimave të luftës, çështja e të humburve. (Marija Stojanović, Luč, Hrvatska. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Qëllimet e KOMRA -së (REKOM)-it do të definohen vetvetiu, nëse ai formohet

(...) mendoj që Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), vetvetiu do të definohen nëse ai formohet. Do të definohen në atë mënyrë, siç thamë të gjithë folësit paraprak, që do të procedohen disa ngjarje, dhe kur ato procedohen atëherë të gjitha ato do i kemi në një vend. (Nail Kajević, Udruženja porodica otetih u Štrpcima, Srbija. Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Koalicioni për KOMRA duhet të ketë qëllime afatshkurtra dhe afatgjata

(...) pajtimi i qëndrueshëm, pajtim i cili vije nga brenda, i cili nuk është imponuar nga jashtë është, në të vërtetë, shumë qëllim i rëndësishëm, ndoshta edhe qëllim afatgjatë, ndoshta këtu është edhe propozimi nga ana ime që të mendojmë mbi kategorinë e qëllimeve afatshkurtra dhe afatgjata të këtij koalicioni. (Filip Pavlović, Fraktal, Srbija . Forumi i gjashtë regjional për të drejtën transitore – Grupi punues: Qëllimet e KOMRA-së (REKOM), Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010).

Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale

Novi Sad, Serbi

20. mars 2010.

Grupi punues: *Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KOMRA-së*

Sugjerimet, opinionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/eve:

Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të komisionit, t'i jepet përparësi intelektualëve të rinj, femrave dhe njerëzve të cilët nuk janë të infektuar nga qëllimet ushtarake, politike dhe qëllimet tjera.

Këtë nen/ pikë, unë do ta kisha reviduar në tërësi, dhe përparësi do t'u epja njerëzve të rinj intelektualë, femrave dhe atyre të cilët nuk janë të infektuar nga qëllimet ushtarake, politike, dhe nga çfarëdo qëllimi tjetër, dhe të jenë të lindur që nga viti 1991. (Mirko Kovaqiq, Nënati e Vukovarit, Kroaci, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) propozoj që numri më i madh i anëtarëve në këtë komision të jenë femra, dhe të jenë të rinjtë të cilët nuk janë të joshur me ideologjinë e cila ka sjellë deri këtu ku jemi sot. (Zahid Kremlj, Shoqata e të kthyerve në Doboj, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Anëtarët e partive politike dhe pjesëmarrësit në luftë, nuk mund të jenë anëtarë të KOMRA-së.

Poqëse do të kemi anëtarë që do të jenë përfaqësues të partive politike apo pjesëmarrës të luftërave, komandantë, do të ketë paragjykime dhe tendencë që procesi nuk është objektiv..) (Shukrije Gashi, Partnerët e Kosovës, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) sa u përket atyre që do të jenë përfaqësues të partive politike, mendoj se pjesëmarrja e tyre nuk do të jetë e mirëkuptueshme, sepse njerëzit do të kenë paragjykim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në komision. (Rexhep Lushta, Qendra për paqe dhe tolerancë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Zyrtarët e Lartë të partive politike nuk mund të jenë anëtarë të KOMRA-së, por anëtarët e thjeshtë të partive politike nuk do të duhej të kenë pengesa për të qenë anëtarë të KOMRA-së.

(...) ata të cilët janë profesionist me vite, të themi kështu, që janë në krye të partive të caktuara politike apo që janë në parlamente, dhe që janë të njohur si njerëz të cilët kanë zhvilluar jetën e tyre politike përmes partive të veçanta politike, ata nuk mund të jenë [anëtarë të KOMRA-së], për shkak të një arsyeje të thjeshtë, sepse do të krijohej përshtypja se ky është komision partiak i cili në princip është, ndoshta në funksion të mbulimit të krimeve apo të fshehjes së krimeve, e kurrësi në funksion të viktimave dhe të zbulimit të fakteve të cilat tregojnë në teknologjinë e krimit në territoret e caktuara (...) unë nuk pajtohem me ata që thonë se pjesëmarrja e thjeshtë ne ndonjë parti do të duhej të jetë pengesë. Ju lutem, ju mund të jeni anëtarë të ndonjë partie, por të mos e udhëhiqni atë parti dhe të mos jeni krijues i vendimeve kyçe të asaj partie, (...) ndërsa është e drejtë qytetare të jeni politikisht të organizuar. (Amir Kulaglic, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Anëtarëve të thjeshtë të partive politike, duhet t'u lejohet të jenë anëtarë të KOMRA-së

Pse do të duhej të jenë anëtarësimi në ndonjë parti, faktor pengues për anëtarësim, veçanërisht kur kemi njerëz të cilët (...) u kanë takuar partive të cilat kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë tregim, edhe pse, natyrisht, kanë qenë të paktë. (Daliborka Uljarevic, Qendra për edukim qytetar, Mali i Zi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Personelit të forcave të armatosura, duhet t'u lejohet të jenë anëtarë të KOMRA-së.

(...) gati në të gjitha shtetet, numri më i madh i popullatës, posaçërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, kanë qenë të mobilizuar, ju lutem, dhe kanë qenë pjesëtarë të armatës. Të jesh anëtarë i ndershem i armatës, nuk është kurrfarë mëkati. Ju e keni mbrojtur veten, keni mbrojtur shtëpinë tuaj, të themi, keni mbrojtur familjen tuaj, dhe nuk e shoh arsyen pse një person i tillë të mos ketë të drejtë që të jetë një ndër komisionerët. (Amir Kulaglic, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) megjithatë mendoj se duhet të fshihet ky paragrafi i dytë, “që nuk ka qenë pjesëtarë i ushtrisë”, sepse ka edhe të ndershem, dhe “që nuk ka pasë të afërm familjarë në pjesëmarrje të ushtrisë” (...) Arsyeja është se kjo, ushtarët të cilët u kanë ndihmuar ushtarëve tjerë të palës kundërshtarë, kur kanë qenë të plagosur, apo kur kanë qenë të zënë rob, sepse nuk kanë guxuar nga individët e caktuar të njërive të tyre, dhe të gjithë ata persona, nënat e sotme të vuajtura, gratë në të zeza, nuk di, gratë e të kidnapuarve, dhe sido që sot quhen tërë ato shoqata, ne të gjitha ato po i lëmë anash. (Mirsad Dizdar, Shoqata e të burgosurve të **kampeve të përqendrimit** në BeH, Shoqata e të burgosurve të **kampeve të përqendrimit** në Jajce, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Në strukturën e KOMRA-së duhet të ketë më shumë hapësirë për të rinj. Në komision duhet të jenë anëtarë nga dy përfaqësues të secilit grup etnik, e jo të shteteve.

(...) të rinjtë e moshës 25 vjeçare mund ta arrijnë pjekurinë intelektuale, prandaj mendoj në strukturën e KOMRA-së se do të duhej të ketë më shumë hapësirë për të rinjtë, sepse ndiejnë përgjegjësi për të kaluarën e baballarëve të tyre dhe e duan qartësinë dhe pastërtinë, histori të pastër dhe jetë më të mirë për në të ardhmen. Sa i përket përfaqësimit sipas shteteve, propozoj që përfaqësimi të bëhet me nga dy anëtarë, por jo në përputhshmëri me shtete ekzistuese apo ato të së kaluarës, por të jenë nga dy përfaqësues nga të gjitha etnitetet, e jo nga shtetet. (Lush Krasniqi, pjesëtar i familjes së viktimave, Gjakovë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Kufiri i moshës për anëtarë në KOMRA duhet të jetë 25 vjeç. Politikanët nuk do të duhej të jenë anëtarë të këtij komisioni.

Sa i përket limitit të moshës të përfaqësuesve, ne jemi për kufirin e moshës 25 vjeç, sepse kemi shumë të rinj të cilët janë të diplomuar dhe që kanë qenë të angazhuar më shumë se dhjetë vite në shoqërinë civile, dhe kanë një prapavijë të përvojës shumë të mirë. Ne jemi kundër pjesëmarrjes së politikanëve në procesin e KOMRA-së, sepse konflikti në ish Jugosllavi është bërë nga politika. (Isuf Halimi, Fisnikët, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Sa i përket limitit të moshës për përfaqësuesit, mendoj se kufiri më i ultë duhet të jetë deri në 25 vjeçar. (Rexhep Lushta, Qendra për paqe dhe tolerancë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Të huajt nuk mund të jenë anëtarë të KOMRA-së, por mund të jenë në rolin e këshilltarëve apo të vëzhguesve.

Unë mendoj se të huajt nuk do të duhej të jenë anëtarë të këtij komisioni rajonal, por mund të jenë në rolin e këshilltarëve apo të vëzhguesve, të cilët do të mund ti ndihmojnë komisionit që më lehtë ta realizojë mandatin e saj duke dhënë këshilla, natyrisht ata do të duhej të jenë njerëzit të cilët kanë përvojë pune në kësi lloj komisionesh jashtë rajonit të cilit do ta përfshijë KOMRA. (Amir Kulagić, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) unë jam kategorikisht kundër që të huajt të jenë anëtarë të komisionit. Pse? (...) vetë puna e komisionit do të duhej të reflektojë përmbajtjen e asaj çfarë kemi arritur ne me forcat tona, diçka që në vetë duam ta bëjmë për veten tonë. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, (Amir Kulagiq, anëtarë

i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Sa u përket të huajve, për shkak të mosbesimit që ka ekzistuar dhe ekziston në disa vende të caktuara, mendoj se ata do të duhej të jenë vetëm vëzhgues të KOMRA-së pa të drejtë vote. (Lush Krasniqi, pjesëtar i familjes së viktimave, Gjakovë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Në komisione duhet të jetë përfaqësuesi i Kombeve të Bashkuara.

(...) sepse numri më i madh i njerëzve në Kosovë dhe Metohi, po flas për pjesëtarët e nacionalitetit serb dhe jo shqiptarë të cilët kanë qenë lojal, dhe të nacionaliteteve tjera, e ata janë romë, turq, Egjiptianë dhe të tjerë, të cilët janë vrarë me ardhjen e trupave paqësore (...) gjatë asaj kohe kur kanë ndodhë krimet, krimet e mëdha, askush nuk është kompetent. Prandaj do t'ju lutem që ai problem i yni, në të vërtetë që ata njerëz të dënohen dhe të jetë prezent përfaqësuesi i komisionit nga Kombet e Bashkuara. (Nataša Šćepanović, familjet e të kidnapuarve dhe të vrarëve nga Kosova e Metohija, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Anëtarë i KOMRA-së nuk duhet të jetë i dënuar. Kjo nuk ka të bëjë me dënimet e regjimeve autoritare të shteteve për shkak të aktiviteteve të tyre politike.

(...) personi i cili do të zgjidhet, nuk duhet të jetë, gjegjësisht nuk duhet të ketë qenë i dënuar. Këtu dua të theksoj se duhet të eliminohen ato elemente, pra, ata persona të cilët kanë qenë të dënuar gjatë regjimit totalitar apo autoritar pas viteve të '90-ta, gjegjësisht para viteve të '90-ta për arsye të përgjegjësisë politike, pra për shkak të aktivitetit të tyre politik. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, (Amir Kulagiq, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Një numër i caktuar i komisionerëve duhet të jenë përfaqësuesit e viktimave.

Mendoj se viktimat apo përfaqësuesit e shoqatave të viktimave do të duhej të kenë një numër të caktuar të komisionerëve, sepse me këtë (...) do ti jepej një kredibilitet dhe legjitimitet më i lartë komisionit rajonal. (Amir Kulaglic, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Anëtarët e KOMRA-së do të duhej të jenë të njohur në shtetet e tyre për angazhimin e tyre në avancimin e të drejtave të njeriut.

Ai person apo ata persona do të duhej të jenë të njohur, nëse jo në rajon, të paktën në shtetet e tyre, për angazhimin e tyre në avancimin e të drejtave të njeriut dhe lirive qytetare, në zhvillimin e shoqërisë civile, në përhapjen e vlerave të shëndosha. (Srećko Čerčanović, Komisioni Komunal i Partisë Demokratike në Zaječar, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Duhet të ekzistojë komisioni në nivelin e çdo shteti, i cili do ti hulumtoj krimet, ndërsa komisioni qendror do ti marrë vendimet, dhe do ta hartojë raportin e përbashkët.

Ne po flasim për një komision rajonal i cili do të jetë komision qendror i përbërë nga komisionerët. Mirëpo, ajo si e vetme nuk do të mund ta kryejë me sukses mandatin e saj deri në fund, prandaj është e rëndësishme, që në periudhën e ardhshme të hapim diskutimin për atë se a do të duhej të ketë komisione në nivel të shteteve, të cilat do të hulumtojnë krimin në ato shtete, dhe që komisioni qendror (...) t'i sjellë vendimet, të hartojë raportin e përbashkët, ndërsa të gjitha komisionet tjera në kuadër të saj të kenë mandatin e kryerjes së pjesës teknike të punës në shtetin konkret. (Amir Kulagić, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Së pari duhet të formohen komisionet nacionale, e pastaj KOMRA.

Që të vijmë deri te formimi i komisionit rajonal, së pari duhet të formohen komisionet rajonale apo secili shtet, veç e veç, por këto komisione të mos quhen zyra apo filiale, por të emërtohen komisione nacionale. (Rexhep Lushta, Qendra për paqe dhe tolerancë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Numri i komisionerëve nga secili shtet duhet të jetë proporcional me numrin e viktimave.

(...) pjesëmarrja e kandidatëve duhet të bazohet në numrin e viktimave (...) vetëm nëse viktimat nuk përzihen me vrasjet, atëherë do të vijmë deri te një propozim fer, poqëse këto dy koncepte përzihen, atëherë nuk do të mund ta formojmë komisionin. (Shukrije Gashi, Partnerët e Kosovës, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) numri i anëtarëve në proporcionalitet me numrin e shteteve të dala nga shpërbimi i ish Jugosllavisë, mendoj se nuk është opsion i mirë, sepse nuk ekziston as interesi, e as numri i viktimave dhe krimeve, as sipas vëllimit e as sipas strukturës. Mendoj se Sllovenia nuk mund të ketë interesim të njejtë për këtë problematikë, po themi poqëse do të krahasohej me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën, sepse edhe në Kosovë por edhe në Bosnjë e Hercegovinë ka më shumë krime sipas vëllimit dhe strukturës, ka shumë viktime. (Amir Kulagić, anëtarë i familjeve

të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

*(...) numri i anëtarëve të atij komisioni, të jenë, le të themi, më së shumti 30, (...) të mos jetë numër i madh, kjo është e para. E dyta, që kriteriumi i cili këtu shpesh po përmendet, kriteriumi, numri i viktimave, kohëzgjatja e konfliktit, e kështu me radhë, gjithsesi duhet të jetë objektiv me rastin e vërtetimit të numrit të anëtarëve të komisionit. (Milena Savić, Qendra për informim dhe ndihmë juridike, Zvornik, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)*

Numri i komisionerëve nga shtetet e caktuara nuk duhet të jetë në proporcion me numrin e viktimave, sepse KOMRA duhet pikërisht të vërtetojë numrin e viktimave.

*(...) kur flasim për numrin e anëtarëve të cilët vinë nga shtete e caktuara, disa herë këtu e kam dëgjuar se ai numër duhet të jetë (...) në proporcion me numrin e viktimave. Dua të theksoj se ne po e themelojmë këtë komision pikërisht për të vërtetuar numrin e viktimave. Pra, ne (...) këtu po e sjellim vetveten në pyetje. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)*

Nga secili shtet duhet të jenë nga tre anëtarë për KOMRA-në.

*Përfaqësimi i shteteve, nga tre anëtarë nga secili shtet, do të ishte mjaftueshëm, dhe mendoj se numri i anëtarëve përfaqësues nga shtetet nuk do të duhej të përcaktohet sipas madhësisë së shtetit pjesëmarrës. (Srećko Čerčanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zaječar, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)*

*(...) nuk mendoj se do të duhet të ekzistojë numri më i madh, apo më i vogël në krahasim me shtetin i cili merr pjesë, sepse nuk është çështja se ata duhet të mbivotojnë në vendime, por në bazë të profesionalizmit dhe kompetencave me fakte të vërtetojnë gjendjen ekzistuese. Në këtë aspekt, nuk shoh arsyen pse do të ketë nevojë për më shumë se 21 anëtarë, mendoj se vlerë matëse e kompromisit është që të gjithë të jenë të përfaqësuar në mënyrë sa më reprezentative. (Daliborka Uljarević, Qendra për arsimim qytetarë, Mali i Zi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)*

Mendoj se 21 anëtarë, është një numër maksimal që do të mund të jenë, e që komisioni të funksionojë, dhe gjithashtu angazhohem që të ketë përfaqësim të barabartë, sepse mendoj se është çështje e përcaktimit, profesional, të pa anshëm dhe objektiv të vërtetimit të fakteve, atë çfarë do të duhej ta bënte komisioni. Mendoj se anëtarësimi në komision nuk do të duhej të jetë pietet për viktimat, por të gjeturat e komisionit do të duhej të jenë në shërbim të viktimave, dhe mendoj se përfaqësimi i Bosnjë e Hercegovinës, e cila padyshim ka pasë më së shumti humbje

dhe e cila disi është më e interesuara për këtë proces, do të realizohet përmes procesit të dëgjimeve publike dhe një lloji të reparacionit, për të cilin shpresojmë se dikur do të realizohet. Jo, assesi në bazë të proporcionalitetit me numrin e viktimave. (Nataša Šćepanović, Shoqata e familajrëve të të kidnapuarev dhe të vrarëve nga Kosova e Metohia, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Personat shpirtërorë nuk duhet të jenë anëtarë të KOMRA-së, por duhet të kenë funksion e këshilldhënies.

(...) ky nuk duhet të jetë komision i konfidenialitetit, i përbërë nga personat e lartë fetar të kishave të cilët do ta diskutojnë këtë, sepse përvoja praktike e historisë ka treguar se me këtë do të duhej të merret shoqëria civile qytetare, dhe ata, do të thotë madje edhe ekspertet fetare, po edhe ata, po mendoj në profesorët universitar etj, por vetëm si një organ këshillëdhënës, të kenë funksion këshillëdhënës në mënyrë që t'ua sqarojnë disa gjëra anëtarëve të komisionit. (Srećko Čeperjanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zaječar, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

(...) unë e përshëndes dhe e përkrahë besimin (fenë) e secilit, por (...) pse po i radhisim tani në anëtarësi, (...) Sepse nëse e shikojmë të kaluarën tonë, të gjitha luftërat kanë ndodhë për shkak të feve të ndryshme, për shkak të besimeve të ndryshëm. (Zvonko Gljuk, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të vitit 1991, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Do të duhet të lejohet pjesëmarrja e udhëheqësve fetarë në KOMRA.

Pjesëmarrjen e udhëheqësve fetarë, unë do ta pranoja ate, sepse udhëheqësit fetarë kanë ndikim të madh te njerëzit, njerëzit kanë besim te ata, dhe ata shumë lehtë mund të arrijnë deri te informatat, si dhe t'i bindin njerëzit të dëshmojnë. (Rexhep Lushta, Qendra për Paqe dhe Tolerancë, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Mendoj se propozimi i koleges është mjaftë i qëlluar, për njerëzit nga bashkësitë fetare, por të kemi kujdes të mos zgjerohemi shumë (...) Por, mendoj se ideja është mjaftë e qëlluar, sepse për arsye të rezultateve të besueshme që do të merreshin, ndoshta do të ishte mirë që ata përfaqësues fetarë të jenë në atë komision. (Drago Kovačević, Forumir Demokratik Serb, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Përsa i përket mënyrës së zgjedhjes të anëtarëve për KOMRA-në, më i mirë është opsioni A.

(...) më të afërt e kam opsionin A, për shkak të thjeshtësisë së tij. Çdo opsion që është kaq i komplikuar, [opsioni B], hapë rrugë për humbje kohe, për paraqitjen e zbrastësirave apo sfidave të paparashikueshme të cilat pastaj mund të zgjaten. (Daliborka Uljarević, Qendra për edukim qytetar, Mali i Zi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Përsa i përket mënyrës së zgjedhjes të anëtarëve për KOMRA-në, më i mirë është opsioni B.

(...) kjo mund të jetë pyetje ideale për shtetet, që në një mënyrë teknike të bllokojnë procesin, sepse nëse unë them se është nga Mali i Zi, më falni, se për mua kandidati nga Serbia është i papërshtatshëm, si dhe ai nga Bosnja, ai nga Kroacia, ndërsa të tjerët janë fantastik, mendoj se dikush nga Serbia do të na thonë – ju nuk mund të na caktoni neve se kush është i përshtatshëm apo jo (...) për mua, më shumë kuptim ka nëse shtetet e japin fjalën e fundit, lidhur me kandidatin e propozuar, në përgjegjësinë e tyre apo të territorit të tyre. (Daliborka Uljarević, Qendra për edukim qytetar, Mali i Zi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Unë jam për opsionin B, mendoj se kjo është një procedurë e cila mund të aplikohet në një periudhë kohore më të gjatë, sipas vlerësimit tim kjo do të zgjasë rreth një vit apo dy, thënë sinqerisht, por unë nuk di për asnjë shembull të iniciativës në shtetet tona ku shoqëritë civile e kanë propozuar listën, e që institucionet shtetërore ta kenë pranuar. (Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Pajtohem me parafolësit, se opsioni A është pothuajse ideal. Por fatkeqësisht, mendoj se objektivisht, asnjë shtet nuk do të pajtohet me këtë model, prandaj më parë do ta shqyrtoja opsionin B, në kuptimin që ndoshta do të ishte më së miri që kandidatët të propozohen nga organizatat jofitimprurëse, shoqatat e qytetarëve, madje ndoshta edhe nga partitë politike, pse jo? Nuk është e thënë që ata kandidatë të jenë nga radhët e tyre, kjo është çështje e përcaktimit të tyre. (Srećko Čeperjanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zajeqar, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Unë jam për kombinimin e opsioneve A dhe B.

(...) unë jam për opsioni mes opsioneve A dhe B, të kombinohen ato, do të thotë të ketë bashkëpunim me qeveritë aktuale për fuqizimin e shoqërisë civile, dhe vënia e kontakteve mes qeverisë dhe shoqërisë civile, sepse për momentin nuk ekziston. (Shukrije Gashi, Partnerët e Kosovës, Kosovë, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Sfida më e madhe do të ishte vëzhgimi i organeve shtetërore për kandidatët e shteteve tjera.

Sfida më e madhe do të ishte kjo faza e tretë, ku (...) listat të cilat do të arrinin nga shtetet e ndryshme dhe të cilat janë të ngushtuara në, të themi, pesë kandidatët më të mirë (...) kur shtetet e ndryshme do të duhej të deklarohen për kandidatët e shteteve tjera, mendoj se është e rëndësishme që të kandidohet në nivelet e shteteve të caktuara, dhe pastaj të kemi mundësinë të propozojmë nga shtetet tjera (...) kjo do të thotë, parlamentet dhe qeveritë të kenë rastin të komentojnë, kjo do të ishte sfida më e madhe, mu për atë sepse në këtë aspekt nuk ka shumë përvojë. (Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Numri i anëtarëve të KOMRA-së duhet të jetë mes 23 dhe 27 anëtarë.

(...) numri i madh i anëtarëve sjellë rrezikun e një organi të stërmadh, i cili nuk do të mund të funksionojë normalisht, por gjithashtu edhe numri i vogël i anëtarëve nuk do ta ketë kapacitetin e duhur, të themi se, nuk do të mund ta kryejë punën e tij në mënyrë konkrete. Megjithatë, numri mes 23 dhe 27 anëtarëve, mendoj se është një numër optimal duke marrë parasysh hapësirën territoriale për të cilën vërtetohen faktet e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut. (Amir Kulagić, anëtarë i familjeve të viktimave, Srebrenicë, BeH, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Parlamenti duhet të zgjedhë dhe të konfirmojë zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA-së, e jo presidenti.

(...) Parlamenti duhet ta zgjedhë, ta konfirmojë, në fakt, zgjedhjen e këtyre anëtarëve. Mendoj se do të duhej të jetë, dy të tretat, do tua them përse. Në fakt, që e tërë kjo ide të ketë sukses, duhet të krijohet një shkallë e lartë të pranimit të të gjitha partive politike në parlament (...) Kurrresi presidenti i republikës, në fakt ai ligjërisht mund ti propozojë disa kandidatë, po jo ti zgjedhë ata, sipas kushtetutës ai nuk është kompetent sipas funksionit që ka. (Srećko Čeperjanović, Këshilli Komunal i Partisë Demokratike në Zaječar, Serbi, Forumi i gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)

Mendoj se numri prej 21 anëtarëve, është maksimumi sa mund të ketë, e që komisioni të funksionojë, gjithashtu unë jam për përfaqësimin e barabartë, sepse mendoj se ajo çfarë duhet të bëjë komisioni është vërtetimi i fakteve në mënyrë profesionale, të paanshme dhe objektive. Mendoj se anëtarësimi në komision nuk duhet të jetë pietet për viktimat, por të gjeturat e komisionit do të duhej të jenë në shërbim të viktimave, dhe mendoj se përfaqësimi i Bosnjë e Hercegovinës, si shteti i cili ka pësuar më së shumti dhe e cila është më e interesuara për këtë proces, do të realizohet përmes dëgjimeve të shumta publike, dhe mënyra e reparacionit për të cilën shpresojmë se dikur do të realizohet. Jo, përfaqësimi kurrresi të mos bëhet sipas proporcionalitetit me numrin e viktimave. (Nataša Govedarica, Serbi, Iniciativa qytetare, Forumi i

gjashtë rajonal për të drejtën tranzicionale, Grupi punues: *Përmbajtja dhe zgjedhja e anëtarëve/eve të KOMRA-së*, Novi Sad, Serbi, 20 mars 2010.)